

UNMIK/REG/2006/19
22 prill 2006

RREGULLORE NR. 2006/19

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2001/19
MBI DEGËN E EKZEKUTIVIT TË INSTITUCIONEVE TË
PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar në harmoni me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 për themelimin e Degës së Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke vepruar me kërkesë të Qeverisë,

Me qëllim të ndryshimit të paragrafit I (iii) të shtojcës 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 për t'i përfshirë shërbimet e sekretarisë për Komisionin për Emërime të Larta Publike në kuadër të zyrës së Kryeministrit,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1
Ndryshimi

Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, paragrafi I (iii) i shtojcës 1 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 ndryshohet si në vijim:

- (iii) Shërbimet e sekretarisë të sigurohen nga zyra e Kryeministrit,

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 22 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm